



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.158/2022

Datë: 28 prill 2022

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108 pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7 paragrafi 1, pika 1.14 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Ljiljana Stevanović, Kryetare në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, sipas Raportit të panelit hetimor Nr.AD/KGJK/08/2022/GJTHM-GJS-2022-007, dhe marrëveshjes vullnetare për pranimin e fajësisë për shkeljen e supozuar, të datës 26 prill 2022, pas shqyrtimit të bërë në pajtim Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe bazuar në nenet 19 dhe 20 të Rregullores (05/2019) për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në seancën e mbajtur më datë 28 prill 2022, nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **Aprovohet** marrëveshja vullnetare për pranimin e fajësisë për rastin disiplinor Nr.AD/KGJK/08/2022/GJTHM-GJS-2022-007, e lidhur në mes të panelit hetimor dhe Kryetares së Gjykatës Themelore në Mitrovicë Ljiljana Stevanović.
- II. Kryetarja e Gjykatës Themelore në Mitrovicë Ljiljana Stevanović është përgjegjëse për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, pika 2.11 dhe 2.16, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe Shkelje të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar.
- III. Për shkeljen disiplinore të vërtetuar si në pikën II të këtij vendimi Kryetares Stevanović i shqiptohet sanksioni disiplinor zvogëlim i përkohshëm i pagës në lartësi prej tridhjetë për qind 30% në kohëzgjatje për katër (4) muaj, të përcaktuar me dispozitën e nenit 7, paragrafi 1, pika 1.3 të të njëjtit Ligj.
- IV. Revokohet vendimi i KGJK-së me numër KGJK.Nr.131/2022, i datës 24 mars 2022 për suspendimin e Kryetares Ljiljana Stevanović.

## A r s y e t i m

Paneli hetimor i themeluar me vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK.nr.130/2022, të datës 24 mars 2022, për lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/08/2022/ GJTHM-GJS-2022-007, më datë 26 prill 2022,



i ka paraqitur Këshillit Gjyqësor të Kosovës raportin me faktet dhe provat e mbledhura si dhe marrëveshjen vullnetare për pranimin e fajësisë të arritur në mes të panelit hetimor dhe Kryetares Ljiljana Stevanović.

Për të shqyrtuar raportin dhe marrëveshjen vullnetare për pranimin e fajësisë, të lidhur në mes të Kryetares së Gjykatës Themelore në Mitrovicë Ljiljana Stevanović dhe panelit hetimor, KGJK më datë 28 prill 2022, ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore.

Nga marrëveshja vullnetare për shkeljen e supozuar në mes të panelit hetimor dhe Kryetares Ljiljana Stevanović, e arritur në procedurën e iniciuar sipas kërkesës disiplinore të parashtruar nga Kryetari i Gjykatës Supreme, konstatohet se marrëveshja është arritur për shkeljet disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, që përcakton “shkelje të detyrave të Gjyqtarit”, përfshirë veprimet e mëposhtme në çoftë se gjyqtari i kryen me dashje apo nga pakujdesia e rëndë”, pika 2.11, “kryen ndonjë funksion, detyrë ose shërbim, merr ndonjë përgjegjësi ose angazhohet në ndonjë aktivitet, kandidon ose zgjidhet në ndonjë funksion apo detyrë që është në kundërshtim me detyrat e gjyqtarit sipas kushtetutës, ligjit për gjykatat dhe Kodit të etikës profesionale për gjyqtar”, dhe pika 2.16, “anëtarësohet në ndonjë subjekt politik, ose ndonjë organizatë tjetër politike, kërkon ose mban ndonjë post politik, kandidon ose zgjedhet në ndonjë post politik apo angazhohet në ndonjë aktivitet politik” të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe Shkelje të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar.

Për panelin hetimor ka qenë jo kontestuese se subjekti i hetimit me këtë rast Kryetarja Stevanović ka kryer shkelje disiplinore të përcaktuara me lartë dhe si rrethanë lehtësuese morri atë se subjekti i hetimit nuk ka pasur me herët ndonjë masë disiplinore të shqiptuar dhe puna dhe përkushtimi i saj ka kontribuar në funksionimin efektiv dhe efikas të punës së gjykatës. Subjekti i hetimit i është përgjigjur në mënyrë të rregullt thirrjes dhe në shkallë të lartë ka treguar bashkëpunim në gjetjen e zgjidhjes së përbashkët për këtë situatë konkrete, për këtë arsyeje edhe janë pajtuar që të nënshkruhet marrëveshja.

Gjatë procedurës tek paneli hetimor subjekti i hetimit dhe paneli hetimor kanë arritur marrëveshje vullnetare me të cilën subjekti i hetimit Kryetarja Stevanović ka pranuar përgjegjësinë disiplinore me të cilën është ngarkuar sipas nenit 5, paragrafi 2, pika 2.11 dhe 2.16, të përcaktuar në Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Shkelje të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar dhe është pajtuar që ti shqiptohet sanksioni disiplinor zvogëlim i pagës për tridhjetë përqind (30%) në kohëzgjatje për katër (4) muaj, siç është përcaktuar në nenin 7, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3, të të njëjtit Ligj.

KGJK, vlerësoi se marrëveshja vullnetare e lidhur në mes të Kryetares Stevanović dhe panelit hetimor, së bashku me dakordimin e tyre për llojin e sanksionit disiplinor të përcaktuar në nenin 7, paragrafi 1, pika 1.3, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, i përmbush të gjitha kushtet ligjore dhe se edhe sanksioni i propozuar nga ana e tyre është i drejtë dhe në proporcion me shkeljen disiplinore të saj, andaj si të tillë edhe e aprovoj.

KGJK-ja e ka pranuar marrëveshjen vullnetare duke vlerësuar faktin se paneli hetimor ka të drejtën e ofrimit të marrëveshjes subjektivit të hetimit si mënyrë e përfundimit të procedurës disiplinore, por pa e ndryshuar kualifikimin e shkeljes e cila pretendohet me kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore, gjë që nënkupton se marrëveshja e arritur në procedurën disiplinore i referohet shkeljeve nga neni 5, paragrafi 2, pika 2.11 dhe 2.16, të përcaktuar në Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Shkelje të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar.

Pasi që KGJK, ka miratuar marrëveshjen vullnetare për pranimin e fajësisë të arritur në mes të panelit hetimor dhe subjektit të hetimit, është vendosur edhe për revokimin e vendimit të KGJK-së me numër numër KGJK.Nr.131/2022, i datës 24 mars 2022, për suspendimin e Kryetares Ljiljana Stevanović.

Vendimi u mor njëzëri nga ana e anëtarëve të pranishëm të Këshillit Gjyqësor.

Me sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilli Gjyqësor i Kosovës**  
**KGJK.nr.158/2022, datë 28 prill 2022**

Albert ZOGAJ,  
  
**Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës**



**Këshillë Juridike:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës.

*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- Enver Peci, Kryetar, Gjykata Supreme e Kosovës;
- Ljiljana Stevanović, Kryetare, Gjykata Themelore në Mitrovicë;
- Arkivit.